

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Kim Jong-un kërkon më shumë armë me “inteligjencë artificiale”, rritet prodhimi ushtarak në Korenë e Veriut
ADRESA	https://www.gazetatema.net/bota/kim-jong-un-kerkon-me-shume-arme-me-inteligjence-artificiale-rritet-prodhim-i587208
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	20 shtator 2026, 08:28:58 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	20 shtator 2026, 08:50:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	b0bf5e3ba4cca0bd2a1ae48f7e321f4ebadc1d65ba6cbd521519f08f0fc97a4a
TEKSTI	324aa0d18d22b12ded2eeb946a822cfcbac3cfd3bcdcd18d664992f9575482fa
PAMJA	48411e3fa8bb89ae637711a84984182e33c56f0e6d800818fa078e54fa13aae6

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	bbe0c61c4320637b669e60d3c0d7558826921c5ebbdb83fe22736ee86573e8cf
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërin nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/bbe0c61c4320637b669e60d3c0d7558826921c5ebbdb83fe22736ee86573e8cf>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

English

Built and Monetized by

[Kontakt](#)



English



ie Zgjedhjet ne Rusi nen sulme kibernetike, Moska pretendon se sistemet e votimit u vune ne shenjester i e shtena me arme ne qender te Sarandes, vritet nje person (EMRI)
fundit

Kim Jong-un kërkon më shumë armë me “inteligjencë artificiale”, rritet prodhimi ushtarak në Korenë e Veriut



20 Shtator 2026, 10:50Bota TEMA



Udhëheqësi i Koresë së Veriut, Kim Jong-un, ka bërë thirrje për përdorimin më të gjerë të inteligjencës artificiale dhe automatizimit në armët sulmuese dhe mbrojtëse të vendit, ndërsa u ka kërkuar prodhuesve të rrisin prodhimin.

Kim i bëri këto deklarata gjatë inspektimit të disa ndërmarrjeve të mbrojtjes, nga e mërkura deri të premten, i shoqëruar nga zyrtarë të lartë dhe motra e tij me ndikim, Kim Yo-jong.

Fotot e publikuara nga mediat shtetërore e tregojnë atë gjatë vizitave në uzina që prodhojnë dronë dhe sisteme artilerie, përfshirë sistemet masive të raketavehdhësve shumëfishtë 600 mm (MLRS).

I njohur jashtë Koresë së Veriut si KN-25, ky sistem ngjan me HIMARS-in e prodhuar në SHBA, por është zhvilluar përtej një sistemi konvencional raketashdhës shumëfishtë, duke funksionuar në praktikë si një lëshues raketash balistike me rreze të shkurtër veprimi.

“Artileria jonë duhet të ketë kapacitet sulmues sa më të përqendruar, shkatërrues, masiv dhe të gjithanshëm, si dhe të përmbushë me përgjegjësi dy misionet e saj: parandalimin e luftës dhe zhvillimin e saj”, deklaroi udhëheqësi i Koresë së Veriut, sipas agjencisë KCNA.

Kim bëri gjithashtu thirrje për përdorim më të gjerë të inteligjencës artificiale në “sistemet e armëve luftarake sulmuese dhe mbrojtëse”, si dhe për përmirësimin e blindimit dhe automatizimit të armatimit të artilerisë, raportuan mediat shtetërore. Ai udhëzoi gjithashtu fabrikat prodhuese të rrisin prodhimin dhe të përmirësojnë “kushtet dhe mjedisin e prodhimit”.

Sipas raportimeve, lideri i Koresë së Veriut “shprehu kënaqësi të madhe”, pasi konstatoi se shumica e fabrikave po përmbushin objektivat e prodhimit për të realizuar “planet e mëdha” të përcaktuara nga Komisioni Qendror Ushtarak i Partisë, organi më i lartë i vendit për çështjet dhe planifikimin ushtarak.

Përpara se t'i bashkohej klubit të vendeve me armë bërthamore në mesin e viteve 2000, Koreja e Veriut mbështetej në një arsenal të gjerë artilerie për parandalim, pasi kryeqyteti i Koresë së Jugut, Seul, ndodhet brenda rrezes së artilerisë konvencionale.

Pheniani ka punuar së fundmi për modernizimin dhe zgjerimin e arsenalit të tij të artilerisë, ndërsa disa prej sistemeve raketore në arsenalin e tij mund të përdoren gjithashtu për transportimin dhe lëshimin e armëve bërthamore.

Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

[Zgjedhjet në Rusi nën sulme kibernetike, Moska pretendon se sistemet e votimit u vunë në shënjestër](#)

10:20 Bota

Merz nën presion, AfD synon një tjetër rezultat të fortë në zgjedhjet rajonale

09:40 Bota

Kultivonin kanabis në një ndërtesë zyrash, dënohen 2 shqiptarët në Britani të Madhe

09:20 Bota / 1 koment

Përshkallëzohet konflikti mes Jemenit dhe Arabisë Saudite, Huthët lëshojnë breshëri raketash dhe dronësh drejt Riadit

09:10 Bota / 2 komente

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.